

DREJTORIA RAJONALE E OSSH ELBASAN

Drejtuar: “BLERIMI” shpk, Adresa: Elbasan, Fshati Mjebes. Zona Topcias, rruga Elbasan-Cerrik
km 4-t, prane lumit Shkumbin.

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur”, me mjete elektronike

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-20688-09-19-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikostruksion i rrjetit TM/TU , kabine, rrjet TU me kabull ABC ne agjensine Gramsh dhe rikostruksion i rrjetit TU me ABC Zona Bujqes , Elbasan”
(objekti sasite dhe kohezgjatja e kontrates) 150 (njqind e pesedhjte) dite nga data e dorezimit te sheshit te ndertimit.

Fondi limit: 67 217 403 (gjashtedhjte e shtate million e dyqind e shtatembedhjte mije e katerqind e tre) lekë pa TVSH

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike date 23.09.2024 , Nr. 63.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “*ERGI*” shpk

K02727229P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 66.899.074,50 (gjashtedhjte e gjashte million e teteqind e nentedhjte e nente mije e shtatedhjte e kater presje pesedhjte) leke pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. “*BLERIMI*” shpk

J62903384G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 66.197.986,51 (gjashtedhjte e gjashte milion e njeqind e nentedhjte e shtate mije e nenteqind e tetedhjte e gjashte presje pesedhjte e nje) leke pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. BOE “*K.M.K sh.pk .& Caushi M shpk*”

L78223801E & L88419801O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 62.105.976,80 (gjashtedhjte e dy milion e njeqind e pese mije e nenteqind e shtatedhjte e gjashte preseje tetedhjte) leke pa TVSH.
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

➤ BOE “*K.M.K sh.pk .& Caushi M shpk*” per arsyet e meposhtme

1. Subjekti K.M.K shpk ka deklaruar se drejtues teknik për realizimin e objektit do të jetë Ing. Elektrik Znj. N.T., e cila nuk është e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, çka bie në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se: Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi”.

Subjekti Caushi M shpk ka deklaruar se drejtues teknik për realizimin e objektit do të jetë Ing. Elektrik Znj. V.M., e cila nuk është e angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë e pranishme gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, çka bie në kundërshtim me UKM nr. 2 , datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2. “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi”.

Sa më sipër, BOE nuk përmbush kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik.

2. BOE nuk plotëson kërkesat e pikes 2.3.10 të “Aftësisë teknike dhe profesionale” ku kërkohej: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.”

- Eskavator me goma – 2 copë. (Caushi M sh.p.k ka paraqitur 1 eskavator me goma me targe AEMT55, ne pronesi, K.M.K ka paraqitur 1 eskavator me goma, ne pronesi me kontrate shitblerje Nr.1462 Rep dhe 695 Kol date 20.05.2019 i patarguar dhe 1 eskavator me goma me qera me kontrate Nr.2549Rep Nr.569Kol, i patarguar) Ploteson vetem 1 eskavator nga 2 cope te kerkuar, Nuk ploteson kriterin
- Minifadrome – 1 copë. (K.M.K sh.p.k ka paraqitur 1 minifadrome, ne pronesi Deklarate doganore R84457 date 16.07.2021 e patarguar) Nuk ploteson kriterin
- Minidamper – 1 copë. (K.M.K sh.p.k ka paraqitur 1 minidamper, me qira me kontrate Nr.5441Rep Nr.1011Kol i patarguar) Nuk ploteson kriterin

Mjetet e paraqitura nga BOE nuk jane sipas kërkesave ne DST, pasi jane deklaruar pa targa. Disponimi i ketyre mjeteve ne perputhje me kodin rrugor eshte kusht pasi punimet do te zbatohen pergjate rrjetit rrugor me qarkullim te panderprere dhe jo ne kantiere te mbyllura me akses te kufizuar. Referuar nenit 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet: 1. “Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod”, klasifikohen si vijon:

k) mjete teknologjike

Ne nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. “Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë”. 2. “Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut”

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: “Për të qarkulluar në rrugë mjetet teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit”. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “Makinat, te cilat lejohen të qarkullojnë ne rruge sipas nenit

113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen prane deges se DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes se qarkullimit dhe të targes të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: AK kerkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar ne percaktimet ligjore te ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit eshte shprehur qartazi ne kerkesat e DST per llojin e mjetit qe kerkon, ne menyre qe plotesimi i kesaj pike te mos jete konfuze per OE. OE nuk ka paraqitur kerkesa per informacion neqoftese do te kishte ndonje paqartasi ne lidhje me kerkesat e mesiperme. (Referuar Vendimit 225/2023 te KPP)

3. BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.11 te “Aftesise teknike dhe profesionale”ku kerkohet: “Per listen e meposhtme te artikujve” ...

- Transformator Fuqie 50 kVA, 10/04 kV

Dokumentacioni i paraqitur nga BOE eshte per trasformator fuqie 250 kVA, 20/04 kV dhe jo sipas kerkesave te percaktuara ne Dokumentat Standarte te tenderit.

4. BOE nuk plotëson kerkesat e pikes 2.3.4 te “Aftesise teknike dhe profesionale”ku kerkohet: “Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme” shoqeruar me Akt-Miratimin nga Agjencia Kombetare e Mjedisit sipas zerave perkates te punimeve ne preventiv ose te kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara.”

Referuar zerave te preventivit eshte parashikuar demontimi i telave, traversave etj te cilat duhet te transportohen dhe magazinohen prane magazinave rekupero te OSSH Elbasan. Ne baze te dokumenatcionit te paraqitur BOE nuk eshte i licensuar per transportin e mbetjeve metalore dhe as nuk ka nje marreveshje bashkepunime me ndonje operator te licensuar per ofrimin e ketij sherbimi. Ne lidhje me deklaraten e paraqitur per te justifikuar plotesimin e kesaj pike ajo nuk merret parasysh nga KVO pasi nuk mbeshtetet ne ndonje dokument zyrtar te institucionit perkates qe leshon kete lloj license, por ne deklarate mjaftohet me fjalet “kjo eshte pergjigja qe kemi marre nga institucionet perkatese”. Minimalisht duhet ti ishte vene AK ne dispozicion kerkesen se cfare pikash jane kerkur te miratohen dhe nje vertetim nga institucioni perkatese ku te theksohet se cilat jane pikat e licenses qe jane miratuar “ne heshtje” per te pare nese ato jane ne perputhje me kerkesat e AK.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “BLERIMI” shpk, Adresa: Elbasan, Fshati Mjebes. Zona Topcias, rruga Elbasan-Cerrik km 4-t, prane lumit Shkumbin, se oferta e

paraqitur me vlerë totale prej : 66.197.986,51 (gjashtedhjetë e gjashtë milion e njeqind e nentedhjetë e shtate mijë e nentëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje pesëdhjetë e një) leke pa TVSH./ totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.